

**SUPREME COURT OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL**

**KOLEGJI I APELIT TË AKP-së**

**ZALBENO VEÇE KAI**

**GSK-KPA-A-1/09**

**Prishtinë**  
**5 Maj 2011**

Në çështjen civile të

**B.J., Q.J. dhe V.J.**

*Ankuesit*

përfaqësuar nga:

**M.R.**

kundër:

**Z.Z.V.**

**Parashtruesi i kërkesës/ Pala përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit të AKP-ës i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Gjyqtarët: Antoinette Lapeltier-Durel, Kryetare e Kolegjit dhe Gjyqtarët Anne Kerber dhe Sylejman Nuredini, në ankesën kundër vendimit të Komisionit të Kërkesave Pronësore të Kosovës KPCC/D/2/2007, ( lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA08426), e datës 3 Shtator 2007, pas shqyrtimit të mbajtur me 5 Maj 2011, morri këtë

### **AKTGJYKIM**

- 1- Refuzohet si e palejueshme ankesa e B.J., Q.J. dhe V.J..
  
- 2- Obligohen ankuesit që të paguajnë shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumë prej € 37.50 (tridhjetë-e-shatë euro e pesëdhjetë cent) mbrenda afatit prej 15 ditësh nga dita kur është dorëzuar aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Ankuesit obligohen që t'i paguajnë shpenzimet bashkërisht dhe në mënyrë solidare.

#### **Historiku faktik dhe procedural:**

Me 9 Janar 2007 paraqitësi i kërkesës Z.Z.V. i ka dorëzuar Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP-ës) padinë për të drejtën e pronësisë së tij në lidhje me palujtshmërinë që gjendet në Komunën e Lipjanit, zona kadastrale e Gushtericës së Poshtme, parcela nr: 1462, fushë e klasës së tretë, me sipërfaqe prej 2303 m<sup>2</sup>. Padia është regjistruar si KPA08426.

Paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se babai i tij, Z.R.V., ka qenë titullar i të drejtës mbi pronën të 1/1 pjesë përkatëse të pronës së pretenduar.

Për ta mbështetur padinë e tij, paditësi i ka siguruar AKP-së fletën poseduese Nr. 638 të Komunës Kadastrale të Lipjanit, të datës 26 Shkurt 1997, që deklaron se parcela nr. 1462 ishte në posedim të R.Z.V..

Fleta Poseduese është vërtetuar prej AKP-së më anë të fletës poseduese nr. 639 e datës 8 Shkurt 2007. AKP-ja po ashtu ka pohuar se humbja e pronës me datë 14 Qershor 1999 ka qenë për shkak të rrethanave që kanë të bëjnë ose që kanë rezultuar prej konfliktit të armatosur që ka ndodhur në mes të 27 Shkurtit 1998 dhe 20 Qershor 1999.

Me 3 Maj 2007 AKP-ja e ka publikuar njoftimin mbi kërkesën.

Me 18 Qershor 2007 Ekipi Njoftues i AKP-së ka shkuar në vendin ku pretendohet se gjendej palujtshmëria dhe ka vendosur shenjat njoftuese që tregonin për kërkesën e parashtruar. Megjithatë, ata nuk i vendosën ato në parcelën e pretenduar nr. 1426, në fshatin Gushtericë e Poshtme në Lipjan por në parcelën nr. 2/66/1, e regjistruar në listën poseduese nr. 33 ZK Petrovici dhe në parcelën nr. 16/6 e regjistruar në fletën poseduese nr. 571, Komuna Kadastrale e Shtimes ( diku rreth 30 km larg prej parcelës së duhur).

Meqë kërkesa e parashtruar nuk u kontestua, me 3 Shtator 2007 Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës (KKPK) mori vendimin grupor KPCC/2/2007 në lidhje me kërkesën e parashtruar, që thekson se *“paraqitësi i kërkesës ose poseduesi i të drejtës mbi pronën, varësisht nga rasti, e ka themeluar të drejtën e pronësisë mbi pronën e pretenduar”*<sup>1</sup>.

Me 30 maj 2008 KKPK-ja e ka identifikuar pronën e pretenduar “Donja Gusterica, Lipjan, fleta poseduese nr. 638, parcela nr. 1426”, duke deklaruar se: *“ Z.Z.V. e ka dëshmuar pronësinë mbi 1/1 të pronës së pretenduar”*<sup>2</sup>.

Me 11 mars 2008 palët përgjegjëse kanë paraqitur para AKP-së ankesë kundër vendimit që ka të bëjë me kërkesën e parashtruar KPA08426, parcela nr: 1426 në Gushtericën e Poshtme. Ata deklaruan se “kjo pronë” është blerë me 14 Shkurt 1956. Për ti mbrojtur pretendimet e tyre ata e kanë dorëzuar edhe një kopje të kontratës mbi dy parcelat. Këto parcela ishin regjistruar në fletën poseduese nr: 33, ZK Petrovici, nën numrin kadastral 2/66/1, në sipërfaqe prej 3.700 m<sup>2</sup> dhe në listën kadastrale me numër 571 të Zyrës Kadastrale të Komunës së Shtimes, parcela kadastrale nr. 16/6 në sipërfaqe prej 1000 m<sup>2</sup>.

Pasi që u vërejt mospërputhja në mes të parcelës objekt kontesi i kësaj lënde dhe parcelës që i referohej paraqitësi i kërkesës, gjykata ka kërkuar prej AKP-së informacione të mëtutjeshme me një letër të datës 19 Maj 2009.

Me letrën e 16 Qershorit 2009 AKP-ja e ka njoftuar gjykatën se, është bërë një gabim gjatë procesit të njoftimit dhe se është njoftuar prona e gabuar për kërkesën fillestare të parashtruar në AKP dhe se njoftimi ishte vendosur në një pronë e cila nuk ishte objekt kontesti.

Me letrën e 7 Korrikut 2009, gjykata i ka njoftuar ankuesit se nuk kishte kontest rreth pronës së tyre, se nuk kishte nevojë që të paraqitej ankesa dhe i ka pyetur nëse ata do ta tërhiqnin ankesën e tyre. Përfaqësuesi i ankuesve e ka marr letrën me 16 Korrik 2009. Ankuesit nuk i janë përgjigjur kërkesës së gjykatës.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa është e pa lejuar.

Ankuesit nuk kanë të drejtë ankese. E drejta e ankesës u takon atyre dhe vetëm atyre- personave të cilët preken kundërshtueshëm nga vendimi i kontestuar. Kjo është paraparë në Nenin 358 Paragrafi 3 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, No. 4/1977, dhe Ligjet mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, publikuar ne Gazetën Zyrtare të RSFJ-ës, Nr. 36/80, 69/82 dhe dispozitat e tjera vijuese), i cili është i aplikueshëm sipas Nenit 533.1 të Ligjit Nr. 03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore.

Vendimi i kontestuar i KKPK-ës, megjithatë, nuk ka ndonjë ndikim ligjor negativ mbi ankuesit. Vendimi ka të bëjë me parcelën nr. 1462, që gjendet në Komunën e Lipjanit, zona kadastrale e Gushtericës së Poshtme. Ankuesit nuk deklarojnë se kjo parcelë është pronë e tyre. Ata vetëm i referohen parcelës nr. 2/66/1 në Petrovici dhe no. 16/6 në Shtime, prandaj edhe për dy parcelat e tjera. Vendimi i KKPK-së nuk ka të bëjë me këto parcela. Prandaj vendimi i kontestuar i AKP-së nuk ka të bëjë me pronën për të cilën ankuesin pretendojnë se është pronë e familjes së tyre. Tutje, ankuesit nuk ndikohen negativisht nga vendimi i AKP-së, ata nuk kanë interes ligjor për të paraqitur ankesë.

Prandaj, ankesa duhet të refuzohet si e pa lejuar.

### **Shpenzimet e procedurës:**

Në bazë të nenit 8.4 të Aneksit III të Urdhërësës Administrative (UA) 2007/5 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët janë të liruara nga shpenzimet e procedurës në Sekretariatit Ekzekutivë dhe Komision.

Sidoqoftë përjashtimi i tillë nuk është paraparë për procedurën para Kolegjit të AKP-ës.

Si pasojë, regjimi normal i taksave gjyqësore siç parashihet me Ligjin për Tarifat e Gjykatës së (Gazeta Zyrtare e KSAK-3 tetor 1987) dhe me UA nr. 2008/02 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Unifikimin e Tarifave të Gjykatës janë të aplikueshme për procedurën para Kolegjit të AKP-ës.

Kështu, taksat e gjykatës të mëposhtme zbatohen për procedurën e ankesës së tanishme:

- Tarifa e taksës gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €

- Gjysma nga tarifa e taksës gjyqësore për lëshimin e aktgjykimit (nenet 10.15, 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pasur parasysh se vlera e pronës në fjalë mund të vlerësohet arsyeshëm si vlerë që përfshinë shumën në mes të € 0 dhe € 1000: € 7.50.

Këto taksa gjyqësore do të barten nga ankuesi i cili humb lëndën dhe i cili nuk e ka tërheq ankesën e tyre edhe pse gjykata ka kërkuar nga ata të bëjnë nëse ata do të dëshironin një gjë të tillë. Ankuesit duhet t'i bartin shpenzimet bashkarisht dhe në mënyrë solidare (Neni 161 Paragrafi 3 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gazeta Zyrtare e RSFJ-ës, 4/1977, dhe Ligjet mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, publikuar ne Gazetën Zyrtare të RSFJ-ës, Nr. 36/1980, 69/19882 dhe dispozitat e tjera vijuese). Afati për pagesë është paraparë në Nenin 45 Paragrafi 1 i Ligjit mbi shpenzimet gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 Tetor 1987).

**Këshillë Ligjore:**

Në pajtim me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme ose të jashtëzakonshme.

**Nënshkruar nga:           Antoinette Lepeltier-Durel, Kryetare e kolegjit të EULEX-it**

**Nwnshkruar nga:       Anne Kerber, Gjyqtare e EULEX-it**

**Nwnshkruar nga:       Sylejman Nuredini, Gjyqtar**

**Nwnshkruar nga:       Urs Nufer, Referent i EULEX -it**